



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 18, Datë 15/02/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 173, datë 09.11.2018, e Z. B.S., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “bindjes politike”¹, nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, në nivel qendror.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Z. B.S. ka filluar punë në datën 17.10.2016, në pozicionin e inspektorit, në Sektorin Operacional të Inspektimit të Policisë Pyjore, pranë Drejtorisë së Inspektoriatit të Policisë Pyjore, të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave (ISHPMU), në nivel qendror. Ankuesi shprehet se në muajin maj 2018, fillimisht i është dhënë masa disiplinore “*vërejtje*”, nëpërmjet Urdhërit nr. 169, datë 02.05.2018, të Kryeinspektorit të ISHPMU-së dhe në vijim nëpërmjet Urdhërit nr. 222, datë 15.05.2018, ankuesit i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ISHMPUT, në nivel qendror, me motivacion “*performancë e dobët në detyrë*”. Ankuesi thekson faktin se ai e ka kundërshtuar masën disiplinore, nëpërmjet e-mailit të datës 07.05.2018, dërguar në adresë të Kryeinspektorit të komanduar të ISHMPUT-së, në nivel qendror, por e-mailit të tij

¹ Referuar vërtetimit nr. 151, datë 08.11.2018, të lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim.

²Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

nuk i është kthyer asnjë përgjigje. Njëkohësisht, ankuesi e ka informuar Komisionerin, se në datën 22.06.2018, ai ka depozituar padi kundër ISHMPUT-së, në nivel qendor, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me detyrimin e palës së paditur, për dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës etj.

Z. B.S. pretendon se ai i ka kryer me korrektësi të gjitha detyrat e ngarkuara, por masa disiplinore dhe në vijim largimi nga puna, kanë ardhur si rrjedhim i diskriminimit që atij po i bëhet për shkak të bindjeve të tij, politike, të cilat janë të ndryshme nga ato të titullarit të tij.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 173, datë 09.11.2018, së Z. B.S. dhe plotësimit të saj me dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga KMD, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, në Nivel Qendror si dhe për dijeni ankuesit, me shkresën nr. 1571/1, datë 12.11.2018, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
- Urdhëri i emërimit në detyrë të Z. B.S.;
 - Kopje e kontratës individuale të punës së lidhur ndërmjet ISHMPUT-së, në nivel qendor dhe ankuesit;
 - Kopje e librezës së punës së ankuesit;
 - Kopje të akteve për dhënie masash disiplinore ndaj ankuesit, si dhe relacioneve përkatëse ose procesverbaleve të mbajtura, ku rezultojnë shkeljet e ankuesit;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Informacion, nëse ankuesi ka paraqitur observacionet e tij, ku kundërshtohet dhënia e masave disiplinore dhe mënyrën se si është reflektuar nga ISHPMU në nivel qendror mbi to. Bashkëlidhur informacionit të dërgohen kopje të shkresave ose e-maileve zyrtare të ISHMPUT-së, në nivel qendror, drejtuar ankuesit;
 - Informacion mbi faktin, nëse janë dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë të ISHPMU, në nivel qendror, përgjatë së njëjtës periudhës janar-qershor 2018. Nëse po, të dërgohen aktet përkatëse, ku të rezultojnë masat e dhëna ndaj tyre;
 - Kopje e aktit administrativ, nëpërmjet së cilit janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesin, si dhe njoftimit për zgjidhje të marrëdhënieve të punës me ankuesin;
 - Informacion nëse gjatë së njëjtës periudhë kohore janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me inspektorë ose punonjës të tjerë të ISHMPUT-së, në nivel qendror. Nëse po, të dërgohen aktet administrative nëpërmjet së cilave janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ta;
 - Kopje të vlerësimeve në punë të dhëna për ankuesin, përgjatë kohës që ka punuar pranë ISHMPUT, në nivel qendror, si dhe të jepet informacioni përkatës, ku të reflektohet performanca e dobët në punë e Z. B.S.;
 - Informacion nëse gjatë së njëjtës periudhë kohore janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me inspektorë ose punonjës të tjerë të ISHMPUT-së, në nivel qendror. Nëse po, të dërgohen aktet administrative nëpërmjet së cilave janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me ta;
 - Çdo akt tjetër administrativ, që ka lidhje me çështjen në shqyrtim.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1571/1, datë 12.11.2018, së Komisionerit, Inspektoriatit Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT) e bën me dije KMD-në, nëpërmjet shkresës nr. 6462/1, datë 06.12.2018, se Z. B.S. është liruar nga detyra e Inspektorit, të Sektorit Operacional të Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoriatit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPU, në nivel qendror, për performancë të dobët në detyrën e deleguar, për të ndjekur dhe asistuar zbatimin e detyrave nga ISHMPU, në degët rajonale, në referencë të pikës 3 “Detyrat”, në Urdhërin nr. 117, datë 03.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror.

Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, pranë KMD-së u dërguan:

- Kopje e dosjes personale të Z. B.S.⁴;

⁴ Dosja personale e Z. B.S. përmban aktet si vijojnë: CV e ankuesit, Diplomë dhe listë notash, certifikatë familjare, vërtetim i gjendjes gjyqësore, vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kopje e kartës së identitetit të ankuesit, raport mjeko-ligjor, vërtetim i lëshuar nga Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë.

- Relacioni përfundimtar, “Mbi zbatimin e Urdhërit nr. 117, datë 03.04.2018”, të Drejtorit të Inspektoriatit të Policisë Pyjore.
 - Urdhërin nr. 117, datë 03.04.2018, “*Për ngritjen e grupeve të punës për inspektim në subjektet që merren me shitjen e materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jo pyjore*”, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Z. Armando Lamaj;
 - Urdhëri nr. 222, datë 15.05.2018, i Kryeinspektorit të ISHMPUT-së “Për zgjidhjen e marrëdhënies së punës”;
1. Në vijim të shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 173, datë 09.11.2018, Komisioneri vendosi zhvillimin e një seance dëgjimore, në datën 28.01.2019, ora 11:00. Palët u njoftuan për këtë seancë nëpërmjet shkresës nr. nr. 14, datë 07.01.2019 “*Njoftim për seancë dëgjimore*”.
 2. Në kushtet kur, zarfi me njoftimin për seancë dëgjimore drejtuar ankuesit u kthye mbrapsht në adresë të KMD-së, në datën 14.01.2019, ankuesi u njoftua me e-mail, për të tërhequr dorazi shkresën nr. 14, datë 07.01.2019 “*Njoftim për seancë dëgjimore*”.
 3. Në datën 24.01.2019, pas ri-njoftimit me telefon, ankuesi B.S. u paraqit për të tërhequr shkresën e sipërpërmendur, si dhe i informoi strukturat përgjegjëse të KMD-së mbi faktin, se ai ka depozituar kërkesëpadi pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, me objekt konstatim diskriminimi, kundër ISHMPUT-së, në nivel qendror. Në këto kushte, ankuesit iu kërkua të depozitonte informacion me shkrim, lidhur me sa më sipër, si dhe të depozitonte pranë KMD-së, një kopje të kërkesëpadisë.
 4. Në vijim, ankuesi dërgoi me e-mail në adresë të KMD-së, kërkesëpadinë me objekt – konstatim diskriminimi kundër ISHMPUT-së, në Nivel Qendror.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 28.01.2019, pranë KMD-së u paraqit vetëm ankuesi B.S. dhe kjo seancë u realizua në mungesë të përfaqësuesve të ISHMPUT-së, në nivel qendror. Në këtë seancë, përfaqësuesit e KMD-së i komunikuan ankuesit, se në kushtet kur çështja mbi konstatimin e diskriminimit është bërë objekt shqyrtimi pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, në referencë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar), ku parashikohet : “*.....Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata....*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehej, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi. Faktet e mësipërme u pasqyruan në procesverbalin e seancës dëgjimore.

I. Përfundimet e Komisionerit

Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” ka parashikuar që individi, i cili që pretendon se është diskriminuar, mund të kërkojë shqyrtimin administrativ të ankesës së tij ndaj subjektit përkatës, pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përveç sa më sipër, në referencë të nenit 36, e vijues të këtij ligji⁵, individit të diskriminuar i njihet e drejta, që në cilësinë e paditësit të ndjekë rrugën e shqyrtimit gjyqësor, lidhur me çështjen e konstatimit të diskriminimit, për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të ligjit të sipërpërmendur.

Z. B.S. ka depozituar në ankesën 173, datë 09.11.2019, pranë Komisionerit, me objekt konstatim diskriminimi për shkak të bindjes politike kundër ISHMPUT-së, në nivel qendror. Ndërkohë që, ankesa e tij ishte në proces shqyrtimi pranë KMD-së, ankuesi ka depozituar kërkesëpadi pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, me palë të paditur – ISHMPUT në nivel qendror dhe objekt padie – konstatim diskriminimi. Pasi u vunë në dijeni të faktit të mësipërm, strukturat përgjegjëse të Komisionerit e informuan ankuesin se në referencë të nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile (i ndryshuar), ku parashikohet : “.....Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata....”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim nuk mund të shprehej më, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të Ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

⁵ Neni 36, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon shprehimisht: “1. Padija i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje. 2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë Komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë. 3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim. 4. Gjykata mund t’i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. 5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese. 6. Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.”

V E N D O S I :

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 173, datë 09.11.2018, së Z. B.S., pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – punësim
Shkak – bindja politike